



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE.

Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr.430, prot AK, datë 07.12.2020, “Përqendrimi ndërmjet Traton SE dhe Navistar International Cooperation”, është njoftuar mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE.

Palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Traton SE është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti; përfshirje në sipërmarrje, të cilat kanë si qëllim të biznesit të tyre prodhimin dhe shitjen e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, aksesorëve të tyre dhe të gjitha impianteve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike. Shoqëria Traton SE nuk ka filial, degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri.

Traton SE është një filial i zotëruar indirekt nga grupi Volkswagen Aktiengesellschaft. Volkswagen Aktiengesellschaft është shoqëria mëmë e Grupit Volkswagen.

Dusk Inc është një shoqëri e regjistruar në Shtetin Delaware, SHBA, i cili zotërohet tërësisht në mënyrë indirekte nga Traton SE.

Shoqëri Target: Navistar International Corporation, është një shoqëri e regjistruar në Shtetin Delaware, SHBA, me objekt aktiviteti: prodhimin e autobusëve të linjës urbane dhe motorë diezel, anije tregtare dhe pasagjerësh, automjete tregtare dhe automjete pasagjerësh dhe makineri bujqësore në Amerikën e Veriut dhe në Amerikën e Jugut, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.